



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE PËR GJIMNAZIN
DHE GJIMNAZIN ME ORIENTIM GJUHËSOR**

LËNDA:

**GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI BËRTHAMË
(PROVIM I DETYRUAR)**

Koordinatorë: Erida Koleci

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

Hyrje

Lënda e Gjuhës shqipe dhe e Letërsisë është provim i detyruar i Maturës Shtetërore për të gjithë nxënësit që mbarojnë gjimnazin. Për këtë, ata do t'i nënshtrohen një testi, në përbërje të të cilit do të jenë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëndë gjatë gjithë viteve të gjimnazit.

Ky test do të zhvillohet mbi bazën e PROGRAMIT ORIENTUES, i cili ndihmon nxënësit dhe mësuesit në fazën parapërgatitore. Programi, gjithashtu, u vjen në ndihmë inspektorëve të IKAP-it, për të monitoruar planifikimin e mësuesit me qëllim sistemimin dhe përforsimin e njohurive të nxënësve.

Programi orientues është mbështetur:

- në programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në kurrikulën bërthamë;
- në Udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit;
- në standardet e fushës së gjuhës shqipe dhe letërsisë;
- në Udhëzimin e MASH-it, Nr. 40, datë 12.10.2011 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2012”.

Udhëzime të përgjithshme

Programi i gjimnazit nuk paraqitet me tema mësimore, por me objektiva që e vënë theksin në rezultatet e të nxënësve. Objektivat e programit të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë realizohen nëpërmjet **teksteve** (teksti tregimtar, teksti poetik, teksti dramatik, teksti bindës/argumentues, teksti përshkruar, teksti shpjegues, teksti informativ, teksti eseistik, teksti kulturologjik). Fakti që nxënësi përballet dhe ushtrohet në tekste të ndryshme, e bën më të lehtë “transferimin” dhe përdorimin e koncepteve, njohurive e aftësive edhe në tekste të tjera.

Kësisoj, testi i Maturës Shtetërore:

- Do të ketë në përbërje **fragmente nga tekste të ndryshme** (tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkruar, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik, tekst kulturologjik), *jo domosdoshmërisht të punuara në klasë*.
- Do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë. Peshat specifike për çdo nivel do të jenë:
 - Niveli bazë: 40%
 - Niveli mesatar: 40%
 - Niveli i lartë: 20%

Struktura e testit do të jetë:

Pjesa e parë: tekst joletrar (40%)

Pjesa e dytë: tekst letrar (30%)

Pjesa e tretë: tekst letrar (30%)

Dy tekstet letrare në test do t'u takojnë:

- një autori shqiptar dhe një autori të huaj;
- dy gjinive të ndryshme (prozë, poezi dhe dramë).

Kjo do të thotë që, në përgatitjen e maturanëve për provimin e Maturës Shtetërore, do të punohet për përvetësimin e aftësive dhe teknikave zbuluese, shpjeguese, zbatuese, analizuese, sintetizuese dhe vlerësuese. Këto aftësi dhe teknika nxënësit do t'i demonstrojnë dhe do t'i zbatojnë në tekste tregimtare, poetike, dramatike, bindëse/argumentuese, përshkruese, shpjeguese, informative, eseistike, kulturologjike, *të punuara apo jo më parë në klasë*.

Pra, nxënësit duhet të aftësohen për objektivat e programit orientues. Ata duhet të jenë të aftë të demonstrojnë arritjet e tyre në të gjitha llojet e teksteve.

- **Objektivat e programit orientues, sipas linjave janë:**

TË LEXUARIT

Linja	Objektivat
Njohuritë mbi fjalën a) Të kuptuarit dhe përdorimi i drejtë i kuptimit të fjalës. b) Interpretimi i kuptimeve të dyta, si pasuri gjuhësore brenda situatës tekstore. c) Vlerësimi i kuptimeve të figurshme të fjalëve.	Nxënësi të jetë i aftë: - të zbulojë kuptimin me të cilin del fjala, në kontekstin që përdoret; - të interpretojë kuptimet e figurshme të fjalëve, si pasuri e shprehjes artistike në një tekst letrar; - të interpretojë kuptimet e <i>dyta</i> të fjalëve, si pasuri gjuhësore e shqipes brenda situatës dhe hapësirës tekstore; - të dallojë kuptimet e figurshme si njësi gjuhësore nga përdorimet e figurshme si njësi të stilistikës letrare; - të vlerësojë kuptimet e figurshme të fjalëve, si pasuri e shprehjes artistike në një tekst.
Strategjitë e të lexuarit a) Përdorimi i strategjive të të lexuarit për të kuptuar një tekst.	Nxënësi të jetë i aftë: - të zbatojë strategji të tilla të të lexuarit, si: strategjia e hartës së tekstit, e problemzgjdhjes, e përmbledhjes dhe e diagramit të Venit;

<p>b) Identifikimi i veçorive të teksteve.</p> <p>c) Evidentimi i veçantive të llojeve të ndryshme të teksteve dhe krahasimi mes tyre.</p> <p>d) Zbulimi dhe vlerësimi i pozicionit të autorit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përdorë informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime; - të parafranojë informacionin e marrë nga tekste të llojeve të ndryshme; - të bëjë përmbledhjen e një teksti; - të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: personazhet, temën, problemzgjdhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera; - të vlerësojë stilin e autorit në tekste të ndryshme.
<p>Pasurimi i fjalorit</p> <p>a) Zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, shprehjet frazeologjike.</p> <p>b) Vlerësimi i figurshmërisë së përdorur në tekste të ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë.</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia; - të analizojë figurshmërinë e përdorur në tekste të ndryshme përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë (fonetike, morfologjike, leksikologjike, sintaksore), për të pasuruar fjalorin; - të pasurojë fjalorin përmes krijimit të fjalëve e të kuptimeve të reja dhe futjes në përdorim të fjalëve dialektore me vlera shënuese e shprehëse; - të pasurojë fjalorin me fjalë të huaja të domosdoshme, duke mënjanuar fjalët e huaja të panevojshme.
<p>Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij Përdorimi i njohurive dhe aftësive për të kuptuar tekstin:</p> <p>a) Evidentimi i rolit të fjalëve në krijimin e tonit dhe atmosferës së veprës.</p> <p>b) Interpretimi i një vepre në drejtim të arritjes artistike, gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike.</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë tekstin (letrar dhe joletrar), si formë e larmishme e ligjërimit; - të tregojë se si teksti pasqyron artistikisht marrëdhënie historiko-shoqërore të një periudhe kohore të caktuar; - të identifikojë karakteristika të kompozicionit në tekste të ndryshme; - të identifikojë karakteristika përmbajtësore të teksteve (tema, tematika, motivi, karakteret); - të dallojë faktin nga opinioni, duke përdorur informacione nga teksti, argumente logjike dhe këndvështrim vetjak; - të dallojë lidhjen logjike të argumenteve në tekste të ndryshme; - të zbulojë qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe ndaj lexuesit të cilit i drejtohet; - të zbulojë se si përdorimi i fjalëve të autorit krijon tonin dhe atmosferën e përgjithshme të veprës;

	<ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë një vepër në drejtim të arritjes artistike, gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike; - të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese midis një teksti të traditës letrare dhe një shkrimi bashkëkohor, duke i vendosur në marrëdhënie krahasuese.
--	--

TË SHKRUARIT

Linja	Objektivat
<p>Shkrimi si proces</p> <p>a) Përfshirja në hapat e domosdoshëm të procesit të të shkruarit.</p> <p>b) Njohja dhe përdorimi i elementeve të sistemit të vlerësimit.</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit: parashkrimi, draftimi, rishikimi (redaktimi e korrektimi); - të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, nënidetë, organizimi, drejtshkrimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij.
<p>Shkrimi si produkt</p> <p>a) Realizimi i një shkrimi për tema, qëllime dhe audienca të caktuara.</p> <p>b) Përdorimi i elementeve të domosdoshme për të përfunduar një shkrim.</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore; - të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përskrime, shembuj, përkufizim, analogji; - të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm; - të zgjedhë fjalët dhe format gjuhësore për të shprehur ngjyime emocionale personale etj.; - të përdorë stil vetjak dhe autorial për të tërhequr vëmendjen e audiencës; - të përdorë drejt kuptimet e para dhe të dyta të fjalëve; - të përdorë struktura, të tilla si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj.
<p>Format e shkrimit, audienca dhe qëllimet</p> <p>a) Demonstrimi i aftësive për të shkruar në forma të ndryshme, për një shumëllojshmëri</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat: - zhvillojnë një ide, - kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me

<p>audiencash dhe qëllimesh, si dhe duke zbatuar kriteret e domosdoshme për çdo formë.</p>	<p>qëllimin, audiencën dhe kontekstin,</p> <ul style="list-style-type: none"> - përfshijnë informacione të rëndësishme, duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme, - mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore, si dhe me detaje të përzgjedhura; - të vlerësojnë si ndikojnë mbi audiencën elemente, të tilla si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja e këndvështrimit.
<p>Drejtshkrimi dhe pikësimi</p> <p>a) Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit.</p> <p>b) Zbatimi i njohurive të gjuhës standarde shqipe.</p>	<p>Nxënësi të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet; - të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak; - të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij.

- **Lista e veprave nga do të përzgjidhen dy fragmentet e tekstit letrar në testimin kombëtar:**

Poezi

Epi i Gilgameshit, Homeri “Iliada”, Populli “Këngë të epikës legjendare shqiptare”, N. Frashëri “Lulet e verës”, De Rada “Këngët e Milosaos”, Bajron “Cajld Harold”, N. Frashëri “Histori e Skënderbeut”, Fishta “Mrizi i zanave”, Pushkin “Eugen Onjegin”, Poradeci “Lirika”, Migjeni “Vargjet e lira”, Camaj “Palimpsest”, I. Kadare “Ca pika shiu ranë mbi qelq”, Uitman “Fije bari”, Bodler “Lulet e së keqes”.

Prozë

Servantes “Don Kishoti”, Barleti “Historia e Skënderbeut”, Hygo “Katedralja e Parisit”, Pashko Vasa “Bardha e Temalit”, Balzak “Evgjeni Grande”, “Xha Gorio”, P. Marko “Qyteti i fundit”, Kadare “Kështjella”/“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, K. Trebeshina “Kënga shqiptare”, Kamy “I huaji”, Markes “100 vjet vetmi”, E. Koliqi “Vepra”, Camaj “Karpa”, Kasem Trebeshina “Odin Mondvalsen”.

Dramë

Eskili “Prometeu”, Shekspir “Romeo dhe Zhuljeta”, Shekspir “Nata e dymbëdhjetë”, Molier “Mizantropi”, Shekspir “Mbreti Lir”/ “Makbeth”/ “Hamleti”, Ibsen “Shtëpi kukulle”/”Armiku i popullit”, Çajupi “14 vjeç dhëndër”, Fishta “Jerina ose mbretëresha e luleve”, Miler “Pamje nga Ura”, E. Haxhiademi “Abeli”, Noli “Izraelitë dhe filistinë”, A. Pashku “Drama”.